



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 09 nëntor 2020  
Nr. ref.:RK 1638/20

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastin nr. KI26/19**

Parashtrues

**Xhavit Thaqi**

**Pronar i kompanisë “NTP INTERBAJ“**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 3480/18, të 24 shtatorit 2018, si dhe të dy njoftimeve të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, KMLC. nr. 162/2018, të 14 nëntorit 2018 dhe 3 dhjetorit 2018**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Xhavit Thaqi, pronar i kompanisë “NTP INTERBAJ“ nga Lipjani (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili, sipas autorizimit, përfaqësohet nga Zyra e Avokatëve “SCRL Partners”, përmes avokatëve Hekuran Haxhimusa dhe Elza Bajrami, nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 3480/18, të 24 shtatorit 2018, si dhe të dy njoftimeve të Zyrës së Prokurorit të Shtetit KMLC. nr. 162/2018, të 14 nëntorit 2018 dhe 3 dhjetorit 2018.
3. Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 3480/18, i 24 shtatorit 2018, i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 10 tetor 2018.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuar, me të cilat, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij, të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

6. Më 7 shkurt 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Me 15 shkurt 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 13 mars 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë dokumente shtesë. Gjithashtu, Gjykata e njoftoi edhe Gjykatën e Apelit lidhur me regjistrimin e kërkesës.
9. Me 22 mars 2019, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi dokumentet e kërkuara nga Gjykata.
10. Më 19 nëntor 2019, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, informata shtesë në lidhje me

rastin, përkatësisht në lidhje me statusin e ankesës kundër Aktgjykimit C. nr. 1119/17, të 26 dhjetorit 2017.

11. Në të njëjtën ditë, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, shkresat e lëndës në lidhje me procedurën penale e cila zhvillohet para saj.
12. Më 29 nëntor 2019, Gjykata pranoi një përgjigje nga Gjykata Themelore në Ferizaj, me të cilën është njoftuar se “[...] në lidhje me rastin C. nr. 1119/18 lënda gjendet para Gjykatës së Apelit që nga data 15.02.2018 me qëllim që ankesa të shqyrtohet, dhe se lënda ende nuk është kthyer nga procedura ankimore.”
13. Më 9 dhjetor 2019, Gjykata Themelore në Ferizaj dërgoi disa dokumente të lëndës të cilat ishin kërkuar nga Gjykata më 19 nëntor 2019.
14. Më 7 tetor 2020, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarës raportuese, Kolegji shqyrtues njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

15. Gjykata, që në fillim të shqyrtimit të fakteve, vëren se procedura lëndore përbëhet nga disa veprime procedurale dhe procedura gjyqësore të cilat kanë specifika të tyre.
16. Më konkretisht, procedura lëndore e parashtruesit të kërkesës përbëhet nga i) procedura përmbartimore e iniciuar nga Dogana e Kosovës kundër parashtruesit të kërkesës, ii) procedura penale e iniciuar nga Dogana e Kosovës kundër parashtruesit të kërkesës, iii) procedura kontestimore e iniciuar nga Dogana e Kosovës lidhur me kompensimin e dëmit, dhe iv) procedura administrative e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës.
17. Lidhur me këtë, Gjykata, me qëllim të shqyrtimit më të mirë të raportit, e sheh të nevojshme t'i ndajë të gjitha këto veprime procedurale, dhe që në vazhdim të raportit t'i paraqesë dhe analizojë ato në një mënyrë e cila do të mundësojë të kuptuarit më të mirë të thelbit të procedurave gjyqësore, si dhe pretendimeve të parashtruesit në kërkesë.

***i) Procedura përmbartimore e iniciuar nga Dogana e Kosovës, dhe ii) procedura penale lidhur me veprën penale “shmangia mashtruese nga taksa e importit dhe akciza nga neni 92 paragrafi 2 i Kodit Doganor të Kosovës”***

18. Më 17 nëntor 2009, Sektori i Auditimit i Doganës së Kosovës nxori Aktvendimin 04.3.2/464, me të cilin e obligoi parashtruesin e kërkesës që për shkak të shmangies së pagesës së detyrimeve doganore me rastin e importit të autoveiturave të përdorura, të paguajë një shumë të caktuar monetare brenda afatit prej 7 ditësh.
19. Njëkohësisht, Dogana e Kosovës paraqiti edhe kallëzimin penal në Prokurorinë Publike Komunale kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të veprës penale



*“shmangia mashtruese nga taksa e importit dhe akciza nga neni 92 paragrafi 2 i Kodit Doganor të Kosovës.”*

20. Më 17 nëntor 2009, parashtruesi paraqiti kërkesë tek Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës, në të cilën kërkoi rishqyrtimin e Aktvendimit 04.3.2/464. Në kërkesën e tij, parashtruesi theksoi se *“procedura e pagesës duhet të pezullohet për shkak të procedurës penale në zhvillim.”*
21. Më 14 janar 2010, Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës përmes Aktvendimit 06.1.4 nr. 1564, refuzoi kërkesën e parashtruesit si të pabazuar. Ndërsa sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me procedurën penale, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës theksoi se *“zhvillimi i procedurës penale nuk mund të lidhet me pagesën e detyrimeve doganore.”*
22. Më 19 shkurt 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Bordin e Pavarur për Rishqyrtime të Doganës së Kosovës duke kontestuar ligjshmërinë e Aktvendimit 04.3.2/464, të 17 nëntorit 2009, dhe në të njëjtën pretendoi shkelje të dispozitave të Kodit Doganor, shkelje të rënda të dispozitave të procedurës administrative, si dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
23. Më 15 gusht 2010, Dogana e Kosovës, në bazë të Aktvendimit 04.3.2/464, të 17 nëntorit 2009, paraqiti në Gjykatën Themelore propozimin për përmbarim në vlerë prej 64,395.56 euro, kundër parashtruesit të kërkesës në cilësinë e debitorit, për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk i kishte përmbushur detyrimet e tij ndaj Doganës së Kosovës brenda afatit të caktuar.
24. Me 20 janar 2011, Prokuroria Publike Komunale paraqiti në Gjykatën Themelore Aktakuzën PP. nr. 1928/2009 kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale *“shmangia mashtruese nga taksa e importit dhe akciza nga neni 92 paragrafi 2 i Kodit Doganor të Kosovës.”*
25. Më 20 nëntor 2012, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin E. nr. 1330/10, me të cilin miratoi kërkesën e Doganës së Kosovës të paraqitur kundër parashtruesit të kërkesës dhe lejoi përmbarimin në shumën prej 64,395.56 euro.
26. Më 25 mars 2013, Bordi i Pavarur për Rishqyrtime i Doganës së Kosovës, miratoi ankesën e parashtruesit të kërkesës të ushtruar më 19 shkurt 2010, dhe nxori Aktvendimin A. nr. 60/2010-DK, me të cilin pezulloi përkohësisht shqyrtimin e ankesës së parashtruesit të kërkesës deri në përfundimin e procedurës penale të iniciuar nga Prokuroria Publike Komunale më 20 janar 2011.
27. Më 7 nëntor 2017, Gjykata Themelore në Ferizaj nxori Aktvendimin P. nr. 450/17, me të cilin hodhi poshtë Aktakuzën e Prokurorisë Komunale të 20 janarit 2011, të ngritur kundër të akuzuarit [parashtruesit të kërkesës], për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, sipas nenit 107 paragrafi 8 në lidhje me nenin 106 paragrafi 1 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale.



28. Me të njëjtin Aktvendim, pala e dëmtuar (Dogana e Kosovës) është udhëzuar në kontest civil në lidhje me kërkesën pasurore, në pajtim me nenin 463 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.
29. Në ndërkohë, parashtruesi i kërkesës paraqiti prapësim në Gjykatën Themelore kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore E. nr. 1330/10, të 20 nëntorit 2012, me të cilin është lejuar përmbarimi. Njëkohësisht, parashtruesi i kërkesës kërkoi edhe anulimin e vendimit për përmbarim.
30. Më 27 qershor 2018, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin e ri E. nr. 1330/10, me të cilin refuzoi, si të pabazuar, prapësimin e parashtruesit. Në Aktvendimin e saj, Gjykata Themelore konkludoi se Aktvendimi në bazë të të cilit është lejuar përmbarimi, i plotëson të gjitha kushtet e parapara në nenin 36 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (në tekstin e mëtejme: LPP), sepse përmban klauzolën se i njëjti është i plotfuqishëm prej 15 janarit 2010, dhe i përmbarueshëm prej 18 shkurtit 2010. Gjykata Themelore gjithashtu theksoi se Aktvendimi është i përshtatshëm për përmbarim në bazë të nenit 27 paragrafi 1 të LPP-së, dhe se një Aktvendim i tillë, i lëshuar nga Dogana e Kosovës, konsiderohet dokument përmbarues në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së.
31. Më 5 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti një parashtresë në Gjykatën Themelore, duke kërkuar që të merret një vendim plotësues. Parashtruesi i kërkesës e bazoi propozimin e tij në faktin se i) Aktvendimi A. nr. 60/2010 i Bordit të Pavarur për Rishqyrtime të Doganës së Kosovës, i 25 marsit 2013, shfuqizoi Aktvendimin e Doganave të Kosovës, në bazë të të cilit është lejuar përmbarimi *“sepse procedura u pezullua duke pasur parasysh se i njëjti ishte në një procedurë penale”*; (ii) procedura penale kundër tij ka përfunduar dhe kjo *“nënkupton që borxhi, siç pretendohet nga kreditori, nuk është konfirmuar në këtë rast, sepse kurrë nuk ka pasur prova se mallrat janë sjellë në Kosovë”*; dhe se (iii) bazuar në Ligjin për Faljen e Borxheve Publike, rezulton që atij i është falur borxhi të cilin konsiderohet se ai e ka bërë në periudhën 2004/2007 dhe se për këtë gjykatat duhet të kujdesen sipas detyrës zyrtare.
32. Në të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës paraqiti edhe një ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj E. nr. 1330/10, të 27 qershor 2018, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës përmbarimore dhe aplikimit të gabuar të ligjit material, dhe në thelb i përsëriti pretendimet e njëjta si në shkresën/kërkesën për marrje të vendimit plotësues, të paraqitur, po atë ditë, në Gjykatën Themelore.
33. Më 24 shtator 2018, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin Ac. nr. 3480/18, me të cilin refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës, dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore E. nr. 1330/10, të 27 qershorit 2018. Në Aktvendimin e Gjykatës së Apelit theksohet se:

*“...qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i ligjshëm, për më tepër Gjykata Themelore drejtë ka aplikuar edhe të drejtën materiale, pasi që ajo ka vendosur në bazë të aktvendimit të Doganës së Kosovës 04.3.2/464 të datës 17 nëntorit 2009, dhe aktvendimit të Drejtorit Gjeneral të Doganës së Kosovës, 06.1.4 nr. 1564 të 14 janarit 2010, në vlerë të*

*përgjithshme prej 64,395.56 €. Gjykata Themelore, në bazë të nenit 21 të LPP-së, theksoi se "organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues dhe dokumentit të besueshëm."*

34. Më 24 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit kërkesën për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.
35. Më 14 nëntor 2018, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit përmes shkresës KMLC. nr. 162/2018, njoftoi parashtruesin e kërkesës se në kontekstin e pretendimeve të tij si dhe provave të siguruara dhe të ofruara, *"është vërtetuar se nuk ekzistojnë arsye ligjore për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë"*. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit iu referua nenit 247 paragrafi 1 pika a) dhe pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK).
36. Më 30 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës dërgoi një shkresë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, përkatësisht kërkesën për rishqyrtim të kërkesës së mëparshme për mbrojtje të ligjshmërisë. Në shkresën/kërkesën e re, parashtruesi i kërkesës theksoi se (i) ligji është aplikuar në mënyrë të gabuar; (ii) duhet të zbatohet Ligji për Faljen e Borxheve Publike; (iii) vendimet e Doganës së Kosovës janë pezulluar në bazë të vendimit të Bordit të Pavarur për Rishqyrtime, dhe si rrjedhojë, nuk ekziston një vendim i plotfuqishëm dhe i përmbarueshëm.
37. Më 3 dhjetor 2018, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, përmes shkresës KMLC. nr. 162/2018, njoftoi parashtruesin e kërkesës se *"në rastin konkret nuk ekzistojnë arsye ligjore për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në kuptim të nenit 247.1 pika a) dhe pika b) të Ligjit për Procedurë Kontestimore"*.

***iii) Procedura kontestimore për kompensim të dëmit e iniciuar nga Dogana e Kosovës kundër parashtruesit të kërkesës***

38. Në një datë të paspecifikuar, Dogana e Kosovës paraqiti në Gjykatën Themelore padinë për kompensim të dëmit kundër parashtruesit të kërkesës, duke pretenduar se ai *"me veprime të kundërligjshme i është shmangur taksave doganore të importit për 34 automjete të importuara, me çka [Doganës së Kosovës dhe Ministrisë së Financave] i ka shkaktuar dëm material"*.
39. Më 18 dhe 21 dhjetor 2017, parashtruesi i kërkesës përmes një shkrese kundërshtoi kërkesëpadinë e Doganës së Kosovës.
40. Më 26 dhjetor 2017, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin C. nr. 1119/17, me të cilin refuzoi kërkesëpadinë e Doganës së Kosovës, dhe arsyetoi se *"pretendimet e paditëses, për kompensim dëmi, ndaj të paditurit janë ngritur mbi bazën e vendimit penal, përmes së cilit i njëjti akuzohej për shmangije nga taksat doganore dhe për këtë ndaj të paditurit është zhvilluar procedura penale nga e cila procedurë kanë rezultuar të pavërtetuara pretendimet e paditëses lidhur me shmangijen nga taksat doganore, kjo për shkak se procedura penale ka rezultuar pasukses ndaj të akuzuarit - tani të paditurit"*. Si rrjedhojë, Gjykata Themelore në Ferizaj refuzoi kërkesëpadinë, *"bazuar në nenin 399 parag. 1*



*lidhur me nenin 14 (Vendimi penal i detyrueshëm për çështjen civile, kur dëmi, pasoja civile, është element i veprës penale) të LPK-së [...]*”.

41. Më 15 janar 2018, Dogana e Kosovës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore C. nr. 1119/17, të 26 dhjetorit 2017. Paditësja (Dogana e Kosovës) theksoi se gjykata e shkallës së parë mori një vendim të kundërligjshëm “sepse nuk vërtetoi gjendjen faktike në procedurën civile në lidhje me konstatimin nëse detyrimet doganore ishin përmbushur nga i pandehuri, por vetëm përmendi provat në mënyrë përshkruese”.
42. Më 1 shkurt 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti përgjigje në ankesë, përmes së cilës, *inter alia*, theksoi se ai nuk ka asnjë detyrim ndaj paditëses, sepse në bazë të Ligjit për Faljen e Borxheve Publike, për çfarëdo borxhi që ka ekzistuar, madje edhe po të mos ishte anuluar aktgjykimi penal, paditësja përsëri nuk do të kishte bazë për kërkesëpadinë.

***iv) Kontesti administrativ i iniciuar nga parashtruesi i kërkesës pas parashtrimit të kërkesës KI26/19 në Gjykatën Kushtetuese***

43. Bazuar në shkresat e lëndës të pranuar nga Gjykata Themelore, Gjykata vuri re se parashtruesi i kërkesës, më 26 shkurt 2019, inicioi në Gjykatën Themelore - Departamenti për Çështje Administrative, procedurën administrative kundër Doganës së Kosovës, duke kërkuar që të lirohet nga pagesa e detyrimeve doganore.
44. Duke pasur parasysh që parashtruesi i kërkesës nuk e njoftoi Gjykatën se ai, më 26 shkurt 2019, inicioi procedurën administrative, Gjykata thekson se ajo, në vazhdim të raportit nuk do t'i paraqesë faktet e kësaj procedure administrative, dhe rrjedhimisht nuk do të merret *ex-officio* me analizën e saj, dhe as me vlerësimin kushtetues të vendimeve gjyqësore në lidhje me këtë rast.

**Pretendimet e parashtruesit**

45. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktvendimet e kontestuar të Gjykatës Themelore, E. nr. 1330/10 të 20 nëntorit 2012 dhe E. nr. 1330/10 të 27 qershorit 2018, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 3480/18, si dhe me dy vendimet e Prokurorisë së Shtetit, i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së.
46. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin e tij janë shkelur nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së, për arsye se në rastin e tij nuk është respektuar barazia para ligjit, për shkak se Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit nuk i shqyrtuan të gjitha pretendimet e tij; gjithashtu edhe Zyra e Prokurorit të Shtetit nuk e pranoi kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, edhe pse në përputhje me nenin 247.1 pikat a) dhe b) të LPK-së nr. 03/L-006, ajo kishte një detyrim ligjor ta bënte këtë, dhe rrjedhimisht ta

dërgonte një kërkesë të tillë edhe në Gjykatën Supreme në mënyrë që ajo të deklarohet në lidhje me shkeljet në fjalë.

47. Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës shton se *“në një çështje të një subjekti tjetër pikërisht me arsyet e cekura në kërkesën e parashtruesit, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka vendosur që të paraqesë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme”*.
48. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse Gjykata Themelore lejoi përmbarimin në bazë të një dokumenti i cili asnjëherë nuk ka pasur tipare të përmbarueshmërisë. Gjithashtu, me shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës vazhdoi edhe Gjykata e Apelit, e cila është dashur t'i shqyrtojë të gjitha pretendimet e palës debitoare se *“... në bazë të nenit 71, paragrafi 1, pika 1.1 dhe 1.2, duke qenë se dokumenti në bazë të të cilit është lejuar përmbarimi asnjëherë nuk ka pasur tipare të përmbarueshmërisë...”*. Në mbështetje të bazueshmërisë së këtyre shkeljeve, parashtruesi i kërkesës gjithashtu shton se *“lidhur me këtë çështje ka pasur procedurë penale, prandaj procedura penale i pezullon procedurat tjera dhe pa u vërtetuar fajësia e të akuzuarit, nuk mund të kërkohej kurrfarë inkasimi në procedurat civile”*.
49. Më tej, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak se Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit veproi në kundërshtim me këto parime, në atë mënyrë që nuk e pranoi kërkesën e tij për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës, nëse për këtë kanë pasur bazë ligjore sipas nenit 247.1 pikat a) dhe b) të LPK-së. Me këtë, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, *“kanë aplikuar gabimisht të drejtën materiale pasi që nga gjykatat e mëparshme, gjegjësisht nga Gjykata Themelore në Ferizaj dhe Gjykata e Apelit nuk ishte marrë parasysh fare falja e borxheve publike sipas Ligjit për Faljen e Borxheve Publike dhe se po ashtu për të njëjtën çështje ishte duke u zhvilluar procedura kontestimore në Gjykatën Themelore në Ferizaj.”*
50. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon edhe shkelje të nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, *“i cili garanton të drejtën e secilit qytetar për ushtrimin e mjeteve juridike, e i cili nen në rastin e parashtruesit është shkelur nga ana e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. [...] Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit duke mos marrë parasysh shkaqet të cilat kanë ekzistuar në kërkesën për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe në një situatë të tillë duke mos e dërguar lëndën e parashtruesit në Gjykatën Supreme ia ka mohuar parashtruesit të drejtën e garantuar me Kushtetutë dhe me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për shfrytëzimin e mjeteve juridike në gjykatë.”*
51. Po ashtu, duke iu referuar nenit 54 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur e drejta e tij për mbrojtje gjyqësore të të drejtave për shkak se Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit nuk ka pranuar që të dërgojë çështjen e tij në Gjykatën Supreme, edhe pse, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, ai dorëzoi prova dhe argumentoi që çështja e tij të dërgohet në Gjykatën Supreme për rishqyrtim.



52. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shpallen të pavlefshme aktvendimet e Gjykatës Themelore në Ferizaj E. nr. 1330/10 të 20 nëntorit 2012 dhe 27 qershorit 2018, Aktvendimi i Gjykatës së Apelit Ac. nr. 3480/18 i 24 shtatorit 2018 dhe Aktvendimi E. nr. 1330/10 i 27 qershorit 2018 dhe çështja të kthehet për rigjykim në Gjykatën Themelore në Ferizaj.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

53. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.
54. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*(...)*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

55. Gjykata, gjithashtu, i referohet edhe paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”*
56. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejné për individët dhe personat juridik (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).
57. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

#### **Neni 47 [Kërkesa individuale]**

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”*

58. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve lidhur me vendimet gjyqësore të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke kontestuar aktin e autoritetit publik, përkatësisht Njoftimin e Zyrës së Prokurorit të Shtetit, KMLC. nr. 162/2018, të 14 nëntorit 2018, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit, si dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
59. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafët (1) dhe (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

*(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar, ose*

*2. Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*

60. Në rastin konkret, Gjykata vëren se të gjitha shkeljet e lartcekura të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, parashtruesi i kërkesës i ndërlidh si me procedurën përmbarrimore të iniciuar nga Dogana e Kosovës në lidhje me detyrimet e borxhit, në të cilën gjykatat kanë zbatuar gabimisht ligjin, ashtu edhe me faktin se Zyra e Prokurorit të Shtetit nuk i pranoi kërkesat e tij për mbrojtje të ligjshmërisë të cilat i paraqiti kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, edhe pse sipas pretendimeve të tij *“Prokuroria në përputhje me nenin 247.1, pikat a) dhe b) të Ligjit të Procedurës Kontestimore Nr. 03/L-006, kishte obligim ligjor për ta bërë këtë.”*
61. Lidhur me këtë, Gjykata do të shqyrtojë bazueshmërinë e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës vis-à-vis shkeljes së pretenduar të neneve 3, 24, 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, të cilat ai i ndërlidh si me vendimet e gjykatave të rregullta lidhur me procedurën përmbarrimore të iniciuar nga Dogana e Kosovës, ashtu edhe me vendimet e Prokurorisë së Shtetit me të cilat janë refuzuar kërkesat e tij për mbrojtje të ligjshmërisë.



62. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës, si shkelje primare, vë në plan të parë drejtëshmërinë e procedurës përmbartimore në tërësi, nga e cila rezultojnë edhe shkeljet e tjera të Kushtetutës dhe KEDNJ-së.

***Pretendimet për shkelje të nenit 31 dhe 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së***

63. Gjykata, duke i shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës të cilat ai i ndërlidh me drejtëshmërinë e procedurës gjyqësore, konsideron se (i) parashtruesi i kërkesës e ka ndërtuar rastin e tij mbi bazat e ligjshmërisë, përkatësisht mbi vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimin e gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta; si dhe mbi pretendimin se (ii) Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e refuzoi kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë në kundërshtim me nenin 247.1 pika a) dhe pika b) të LPK-së.
64. Më konkretisht, në lidhje me të dy pretendimet, përkatësisht me pohimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me ligjshmërinë e vendimeve të kontestuara të gjykatave dhe të Prokurorit të Shtetit, Gjykata rikujton se ajo në vazhdimësi ka theksuar se këto pretendime nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata (shih, lidhur me këtë, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; KI154/17 dhe KI05/18, parashtruesit e kërkesës *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shogëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 gushtit 2019, paragrafi 60; KI192/18, parashtruesi i kërkesës *Kompania Kosovare për Distribuid dhe Furnizim me Energji, KEDS Sh.a.*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 gushtit 2019, paragrafi 49).
65. Gjykata, gjithashtu, përmes praktikës së saj gjyqësore ka theksuar vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit, që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për atë sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë "*e shkallës së katërt*", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin e GJEDNJ-së, *García Ruíz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtruesit e kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011; KI154/17 dhe KI05/18, parashtruesit e kërkesës *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shogëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 gushtit 2019, paragrafi 61; dhe KI192/18, parashtruesi i kërkesës *Kompania Kosovare për Distribuid dhe Furnizim me Energji, KEDS sh.a.*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 gushtit 2019, paragrafi 50).
66. Detyrë e Gjykatës është që të shqyrtojë procedurën në tërësi, që në rastin konkret, përveç vendimeve të gjykatave të rregullta, përfshin edhe vendimin e Prokurorisë së Shtetit (shih, ndër të tjera, Aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin *Helmerts kundër Suedisë*, të 29 tetorit 1991, Seria A nr. 212, fq. 15, par. 31).

Gjithashtu, nuk bie në juridiksionin e GJEDNJ-së që në vend të vlerësimit vetanak të fakteve të merr përsipër interpretimin e gjykatës vendore, përderisa është rregull i përgjithshëm që gjykata vendore t'i vlerësojë dëshmitë të cilat i paraqiten asaj. Është detyrë e Gjykatës të konstatojë nëse procedura në tërësi ka qenë e drejtë, përfshirë edhe mënyrën e paraqitjes së provave në procedurat ankimore (shih, ndër të tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 79/1991/331-404, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, paragrafi 34).

67. Duke u kthyer në pretendimin konkret të parashtruesit të kërkesës lidhur me faktin se Gjykata Themelore vërtetoi gabimisht gjendjen faktike kur vendosi të lejojë përmbarimin e një dokumenti, i cili në vetvete nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, Gjykata vëren se ky pretendim ankimor, si argument i parashtruesit të kërkesës, tashmë është analizuar dy herë nga Gjykata Themelore, si në Aktvendimin E. nr. 1330/10, të 20 nëntorit 2012, ashtu edhe në Aktvendimin E. nr. 1330/10, të 27 qershorit 2018.
68. Më konkretisht, Gjykata gjeti se Gjykata Themelore, në bazë të propozimit të Doganës së Kosovës, lejoi përmbarimin e Aktvendimit 04.3.2/464, të 17 nëntorit 2009, i cili, sipas konkluzionit të Gjykatës Themelore, është bërë i plotfuqishëm dhe i përmbarueshëm. Në fakt, Gjykata Themelore mori një vendim të tillë vetëm pas skadimit të afatit të përcaktuar me ligj, brenda të cilit, parashtruesi i kërkesës nuk i përmbushi detyrimet e tij monetare ndaj kreditorit (Doganës së Kosovës).
69. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktvendimit të shkallës së parë të Gjykatës Themelore, duke theksuar disa argumente ankimore, ndër të cilat ishin argumentet se *i) "aktvendimi i Doganës së Kosovës në bazë të dispozitave të aplikueshme të Ligjit për procedurën përmbarimore nuk i plotëson kushtet për ekzekutim"; dhe se ii) "vendimi i kundërshtuar nuk është as ekzekutiv e as i plotfuqishëm, sepse procedura sipas ankesës ishte në zhvillim"*.
70. Gjykata gjen se Gjykata Themelore në Aktvendimin E. nr. 1330/10, të 27 qershorit 2018, është përgjigjur në tërësi në të gjitha pretendimet ankimore, duke ofruar arsyetimin konkret juridik për secilin pretendim veç e veç, për të cilin arsyetim kjo Gjykatë nuk gjen se është arbitrar apo i pabazuar.
71. Më konkretisht, sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se *"aktvendimi i Doganës së Kosovës në bazë të dispozitave të aplikueshme të Ligjit të procedurës përmbarimore nuk i plotëson kushtet për ekzekutim"*, Gjykata Themelore ishte e mendimit se një argument i tillë ankimor i parashtruesit të kërkesës *"është i pabazuar për arsye se aktvendimi në bazë të të cilit është caktuar përmbarimi nga Gjykata siq vërtetohet nga shkresat e lëndës i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore të kërkuara me nenin 36 par. 1 të LPP-së ngase siq shihet ky aktvendim i ka të vendosura klauzolën se aktvendimi është i formës së prerë nga data 15.01.2010, si dhe klauzolën se aktvendimi është ekzekutiv përkatësish i përmbarueshëm."*



72. Gjykata rikujton se neni 36 i Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, në të cilin u thirr Gjykata Themelore, rregullon çështjen e përmbarueshmërisë së një dokumenti:

Neni 36 Vërtetimi për përmbarueshmërinë

*“1. Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri.  
2. Vërtetimin për përmbarueshmërinë e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë.  
[...].”*

73. Përveç kësaj, Gjykata gjen se Gjykata Themelore u përgjigj në mënyrë të argumentuar edhe në pretendimin e parashtruesit të kërkesës në lidhje me faktin se Aktvendimi i Doganës së Kosovës nuk i plotëson kushtet si titull përmbarues për arsye se ai kishte paraqitur ankesë kundër Aktvendimit përmbarues të Doganës së Kosovës. Një pretendim të tillë ankimor Gjykata Themelore nuk e vlerësoi si të bazuar, me arsyetimin se *“aktvendimi në fjalë përveq që është i pajisur me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri i njëjti e përmban edhe klauzolën se ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e këtij aktvendimi.”*
74. Gjykata është e mendimit se një qëndrim i tillë i Gjykatës Themelore ka argumentimin si faktik ashtu edhe ligjor, për të cilin kjo Gjykatë nuk gjen se është arbitrar dhe i pabazuar në ligj.
75. Sa i përket pretendimeve ankimore në lidhje me procedurën ankimore para Gjykatës së Apelit, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendimet për shkelje në procedurën para Gjykatës së Apelit i ndërton mbi pretendimin se Gjykata e Apelit nuk i mori në shqyrtim të gjitha pretendimet e tij ankimore, më konkretisht, pretendimin në lidhje me shkeljen e procedurës përmbarimore nga Gjykata Themelore, përkatësisht se Gjykata Themelore e pranoi një dokument si përmbarues edhe pse nuk është në përputhje me LPP-në.
76. Gjykata, duke analizuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, si dhe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, të cilit i referohet pretendimi ankimor, konstaton se, konkretisht, sa i përket këtij pretendimi ankimor, Gjykata e Apelit, *inter alia*, konkludoi se *“pretendimi ankimor i të autorizuarit të debitorit në ankesë, se Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore, është i pabazuar, pasi aktvendimi i lëshuar në rastin konkret është dokument përmbarues [...] dhe i njëjti i plotëson kushtet për përmbarim në bazë të dokumentit përmbarues, siç është përcaktuar me nenin 21 të LPP-së, si dhe nenin 24 par. 3 dhe 27 par. 1 të po këtij ligji”*.
77. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se neni 21 i LPP-së, në pjesën relevante thotë:

Neni 21. Bazat juridike për caktimin e përmbarimit

*“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

78. Duke pasur parasysh vetë përmbajtjen e nenit 21 të LPP-së, Gjykata gjen se Gjykata e Apelit konstatoi se në bazë të dispozitës relevante ligjore, dokumenti, përkatësisht Aktvendimi i Doganës së Kosovës, në bazë të të cilit parashtruesi i ndërton pretendimet ankimore paraqet një *titulus executionis* dhe se ai, si i tillë, i plotëson të gjitha kushtet e përmbarueshmërisë të përcaktuara me ligj.
79. Për më tepër, Gjykata gjithashtu gjen se Gjykata e Apelit e bazoi arsyetimin e saj edhe në dispozitat relevante të nenit 24 paragrafit 3 dhe nenit 27 të LPP-së.
80. Lidhur me këtë, Gjykata gjen se në dispozitat relevante të nenit 24 paragrafit 3 dhe nenit 27 të LPP-së thuhet:

*Neni 24. Përmbarueshmëria e vendimit*

[...]

*3. Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.*

*Neni 27. Përshtatshmëria e dokumentit përmbarimor*

*1. Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.*

*2. Në qoftë se me anë të dokumentit përmbarues nuk është caktuar afati për përmbushje vullnetare të detyrimit, afati i tillë do të caktohet me anë të aktvendimit për përmbarimin, dhe urdhrit për përmbarim, për shtatë (7) ditë.*

81. Duke pasur parasysh një argumentim të tillë të Gjykatës së Apelit, si dhe dispozitat ligjore të përdorura nga Gjykata e Apelit si bazë juridike, Gjykata nuk gjen asnjë arbitraritet, as në vërtetimin e fakteve në lidhje me natyrën e dokumentit përmbarues e as në natyrën e tij juridike e cila do të ndikonte në drejtëshmërinë e procedurës së zhvilluar para Gjykatës së Apelit.
82. Përveç kësaj, Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës shkeljen e neneve 31 dhe 32 të Kushtetutës e ndërlidh edhe me refuzimin e kërkesës së tij për mbrojtje të ligjshmërisë nga Prokurori i Shtetit.
83. Më konkretisht, në mbështetje të këtyre shkeljeve, parashtruesi i kërkesës pretendon *i)* se Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka vepruar në kundërshtim me parimin e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së “*duke mos pranuar kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës përkundër se kishte bazë juridike në bazë të nenit 247.1, pikat a) dhe b), dhe ii) shkeljen e nenit 32 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën e secilit qytetar për ushtrimin e mjeteve juridike, e i cili nen në rastin e parashtruesit është shkelur nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, sepse ajo e refuzoi kërkesën e tij*”.
84. Gjykata fillimisht gjen se në nenin 247 pikat a) dhe b) të LPK-së nr. 03/L-006, në pjesët relevante thuhet:



*“Prokurori publik mund ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë:*

*a) për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, në qoftë se shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale, po qe se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse e ka pasur detyrë ta mbajë seancën kryesore, po qe se është vendosur për kërkesën, rreth së cilës kontestimi është në vazhdim, apo në qoftë se në kundërshtim me ligjin, është përjashtuar publiku në seancën kryesore;*

*b) për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale.*

*[...]”*

85. Duke e sjellë në lidhje pretendimin ankimor të parashtruesit të kërkesës me vendimin e Prokurorit të Shtetit me të cilin është refuzuar kërkesa për ngritje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë para Gjykatës Supreme, Gjykata vëren se vetë përmbajtja e dispozitës ligjore të nenit 247 të LPK-së është e pakontestueshme dhe se e njëjta, së pari, i jep parashtruesit të kërkesës mundësinë që të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij edhe me një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë para Prokurorit të Shtetit, mirëpo, gjithashtu është i pakontestueshëm edhe fakti se miratimi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga Prokurori i Shtetit kushtëzohet nga përmbushja e disa kushteve, të përcaktuara në pikat a) dhe b) të nenit 247 të LPK-së.
86. Duke analizuar vendimin e Prokurorisë së Shtetit i cili kontestohet nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata gjeti se Prokurori i Shtetit, si kriter kryesor për refuzimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë e përdori pikërisht kushtin e përcaktuar me nenin 247 pikat a) dhe b) të LPK-së. Më konkretisht, Prokurori i Shtetit në vendimin KMLC. nr. 162/2018, ndër të tjera, theksoi se përkundër faktit që ai i siguroi shkresat e lëndës E. nr. 1330/2010 nga Gjykata Themelore, dhe pas analizës së gjithanshme të të gjitha provave në kontekst të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, arriti në përfundim se pretendimet në kërkesë dhe provat e ofruara dhe të siguruara çojnë në konkluzionin e tij se nuk ekzistojnë arsye ligjore për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, sepse nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara në pikat a) dhe b).
87. Në bazë të të lartcekurave, Gjykata gjen se Prokurori i Shtetit, duke pasur parasysh arsyetimin e dhënë në vendim, i analizoi me kujdes të gjitha pretendimet ankimore në kontekst të përmbushjes së të gjitha kushteve të përcaktuara në nenin 247 pikat a) dhe b) të LPK-së, që do të mundësonin miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Megjithatë, edhe pas analizës së gjithanshme të të gjitha shkresave të lëndës, ai konkludoi se arsyet e përdorura nga parashtruesi i kërkesës në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të dispozitës ligjore në fjalë.
88. Rrjedhimisht, Gjykata mund të konkludojë se pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së janë të pabazuara.
89. Më tej, sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se procedura përmbartimore do të duhej të pezullohej nga gjykatat e rregullta për arsye se

Dogana e Kosovës inicioi procedurën penale kundër tij për veprën penale “*shmangia mashtruese nga taksa e importit dhe akciza nga neni 92 paragrafi 2 i Kodit Doganor të Kosovës*”, dhe se në këtë procedurë nuk është vërtetuar përgjegjësia e tij penale, Gjykata vëren se këto pretendime ishin ngritur nga parashtruesi edhe para Gjykatës Themelore, por se ato, si të tilla, ishin refuzuar për arsye se kjo ishte një vepër penale e mundshme, për të cilën, sipas Ligjit për Procedurën Penale, kemi një procedurë gjyqësore të një natyre tjetër, e cila i ka rrugët e veta procedurale. Rrjedhimisht, Gjykata edhe këto pretendime të parashtruesit të kërkesës i gjen të pabazuara.

90. Duke pasur parasysh se Gjykata konkludoi se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së është i pabazuar, ajo gjithashtu mund të konkludojë se edhe pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së është i pabazuar, për arsye se Gjykata tanimë gjeti se parashtruesi i kërkesës përdori një mjet juridik të përcaktuar me ligj, por që ai, si i tillë, nuk ishte efektiv, duke pasur parasysh vetë përmbajtjen dhe arsyet mbi të cilat parashtruesi i kërkesës e bazoi kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë para Prokurorisë së Shtetit.

***Pretendimet për shkelje të nenit 3 dhe 24 të Kushtetutës, si dhe nenit 14 të KEDNJ-së në lidhje me trajtimin e pabarabartë***

91. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, Gjykata thekson se neni i përmendur i Kushtetutës nuk bie nën Kapitullin II Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Kushtetutës dhe rrjedhimisht me këtë nen nuk garantohen të drejtat dhe liritë individuale. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata konkludon se nuk do të merret me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës.
92. Megjithatë, Gjykata gjithashtu gjen se parashtruesi i kërkesës vë në dukje edhe pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me trajtimin e pabarabartë e të cilat i ndërlidh me faktin se “*në një çështje të një subjekti tjetër pikërisht me arsyet e cekura në kërkesën e parashtruesit, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka vendosur që të paraqesë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.*” Duke i ndërlidhur pretendimet me rastin konkret, si dhe me garancitë dhe parimet e nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së, Gjykata vëren se, në thelb, parashtruesi i kërkesës të gjitha pretendimet e lidhura me pohimet e tij, i sjellë në kontekstin e drejtëshmërisë së procedurës përmbartimore.
93. Megjithatë, Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës, përveç pretendimeve për trajtim të pabarabartë në lidhje me padrejtëshmërinë e procedurës, nuk paraqiti asnjë provë që mund të tregonte se ka pasur me të vërtetë diskriminim apo trajtim të pabarabartë mbi çfarëdo baze, siç thuhet në nenin 24 të Kushtetutës ose nenin 14 të KEDNJ-së, përkatësisht se është trajtuar ndryshe në raport me palën tjetër në një situatë të njëjtë ose të ngjashme, dhe kjo nuk rezulton as nga dokumentet e paraqitura në Gjykatën Kushtetuese. Vetë fakti se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur në Gjykatë një vendim të Prokurorit të Shtetit në lidhje me një rast tjetër, nuk çon vetvetiu në përfundimin se ekziston trajtimi i pabarabartë. Në fakt, çdo kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë



që i paraqitet Prokurorit të Shtetit i ka specifikat e veta të cilat mund të jenë të rëndësishme për reagimin ose mosreagimin e Prokurorit të Shtetit.

94. Prandaj, Gjykata konsideron se pretendimet për trajtim të pabarabartë të parashtruesit të kërkesës janë paushalle, ndërsa arbitrariteti i mundshëm i gjykatave në këtë procedurë gjyqësore nuk është i dukshëm. Duke pasur parasysh të gjitha të lartcekurat, Gjykata konsideron se janë qartazi (prima facie) të pabazuara edhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të parimit të ndalimit të diskriminimit nga neni 24 i Kushtetutës dhe neni 14 i KEDNJ-së në lidhje me të drejtën për një gjykim të drejtë nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.
95. Gjykata shton se fakti i thjeshtë që parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurës gjyqësore nuk është kusht i mjaftueshëm që të ndërtohet pretendimi për shkelje kushtetuese. Gjykata rikujton se kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë aspekt, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI136/14, parashtrues *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
96. Rrjedhimisht, në këto rrethana, bazuar në sa më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata, duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën gjyqësore të Gjykatës në raste të ngjashme dhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij lidhur me shkeljet e të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
97. Prandaj, kërkesa dhe pretendimet në lidhje me këtë pjesë të procedurës gjyqësore, të cilat Gjykata i ka analizuar në detaje, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohen të papranueshme në pajtim me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

### ***Procedura kontestimore e iniciuar nga Dogana e Kosovës lidhur me kompensimin e dëmit***

98. Duke pasur parasysh faktin se procedura kontestimore lidhur me kompensimin e dëmit e iniciuar nga Dogana e Kosovës kundër parashtruesit të kërkesës është ende në fazën e vendosjes para Gjykatës së Apelit, Gjykata konkludon se ajo nuk do t'i shqyrtojë vendimet e nxjerra në këtë procedurë. Gjithashtu, Gjykata nuk do të shqyrtojë as pretendimin ankimor të parashtruesit të kërkesës se *"nga Gjykata Themelore në Ferizaj dhe Gjykata e Apelit nuk ishte marrë parasysh fare falja e borxheve publike sipas Ligjit për Faljen e Borxheve Publike"*, pikërisht për arsye se parashtruesi i kërkesës në procedurën ankimore para Gjykatës së Apelit, e përdori këtë argument si argumentin kryesor ankimor për paraqitjen e përgjigjes, për të cilin Gjykata e Apelit ende nuk është deklaruar.
99. Rrjedhimisht, Gjykata, në bazë të parimit të subsidiaritetit, konstaton se kërkesa e parashtruesit, si në lidhje me procedurën kontestimore, ashtu edhe në lidhje me pretendimet që i referohen asaj, janë të papranueshme për shqyrtim, për shkak se kërkesa është e parakohshme. Më konkretisht, gjykatat e rregullta

gëzojnë përparësi në shqyrtimin e të gjitha çështjeve të ngritura nga parashtruesi i kërkesës. Kjo gjithashtu nënkupton se, pa paragjykuar procedurat para gjykatave të rregullta, asgjë nuk e pengon parashtruesin e kërkesës që në të ardhmen të paraqesë përsëri kërkesë në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit ligjor prej katër (4) muajve nga dita e pranimi të vendimit përfundimtar të gjykatave të rregullta në lidhje me këtë procedurë kontestimore.

100. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës në lidhje me këtë procedurë gjyqësore është e parakohshme dhe duhet të deklarohet e papranueshme, siç përcaktohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 (2) të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 (2) të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) dhe (2) të Rregullores së punës, më 7 tetor 2020, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Arta Rama-Hajrizi

